# TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

**Emri I NSH-së**

N.SH. "VRESHTARIA" ("Ndërmarrja")

**Emri I Ndërmarrjes së re**

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Toka Bujqësore në Smaq SH.P.K.** ( "Ndërmarrja e Re")

Ofertimi për Ndërmarrjen e Re duhet të përfshij vetëm tokën bujqësore në Zonën Kadastrale Smaq, Komuna e Prizrenit.

**Vendndodhja**

Zona Kadastrale Smaq, Regjioni i Prizrenit

**Biznesi/Sektori**

Agrobiznes/Vreshtari

**Prodhimet**

Produktet në të kaluarën përfshinin varietete të ndryshme të rrushit të verës dhe të tryezës. Tani NSH-ja nuk është aktive dhe nuk ka prodhime.

**Tregu**

Ndërmarrja kryesisht ka mbuluar tregun ushqimor të Kosovës, duke i përfshirë verarитë Kosovare si ajo e NBI Rahoveci, NBI Suhareka dhe "Kosovavera" në Krushë të Vogël, Komuna e Prizrenit.

**Konkurrenca**

Ndërmarrja tani kryesisht ballafaqohet me konkurencën e prodhimeve prej importit dhe në një shkallë më të vogël nga agrobiznesi kosovar.

**Punonjësit**

Ndërmarrja ka 101 punëtorë. Prej tyre 17 janë aktivë dhe punojnë si roje. Ata janë të punësuar nga AKP-ja – Departamenti i Administrimit Direkt sepse NSH-ja prej vitit 2004 është nën administrimin direkt të AKM-së/AKP-së. Punëtorët e tjerë janë në pushim pa pagesë.

**Ndërtesat dhe tokat**

**Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Toka Bujqësore në Smaq SH.P.K.** Oferta për ndërmarrjen e re përfshinë tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 18 ha 35 ari 20 m² (183520 m²). Kjo sipërfaqe prej 18 ha 35 ari 20 m² (183520 m²) është e

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitoret potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitoret potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: http://www.pak-ks.org

regjistruar në emër të “PRONA SHOQËRORE-KIB PROGRES” :

Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71813074-00151 e datës 15/03/2011.

Meqenëse ZR e AKP-Prizren ka bërë kërkesë zyrtare në AKP ZQ-Prishtinë për incizim të gjendjes faktike të lokacionit nga ana e Kontaktorit, sipërfaqja e saktë e lokacionit që është lëndë e këtij tenderi do të caktohet pas kryerjes së matjeve nga ana e Kontraktorit dhe azhurnimit të të dhënave kadastrale.

**Detyrimet që do të bartën**

**(1)** Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

**(2)** Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

**(3)** Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

**(4)** Kosto e furnizimit te mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i perfshire pagat, pensionet ose pagesat tjera per ose ne emer te punetoreve te NSh-se ne kapacitetin e tyre si punetore) e mbledhur gjate rrjedhes normale te biznesit qe:

a) Eshte mbledhur gjate periudhes tre mujore qe perfundon ne daten kur deklarata relevante e transferit ka hyre ne fuqi;
b) Qe mbetet e papaguar deri ne ate date dhe i ngarkohet biznesit te NSH-se.

Asnjë obligim nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re. Të gjitha obligimet do të mbeten në NSH. Nuk ka hipotekë mbi asetet të cilat do të privatizohen.

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitoret potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitoret potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: http://www.pak-ks.org

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Foto inqizimi ajror i Ndërmarrjes së Re**

NSH 'PROGRES' - VRESHTARIA NewCo 1 Z.K SMAQ




**Informatat**

Departamenti I shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 500 400
www.pak-ks.org

**Dokumentet e ofertimit**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Ilir Konushevci Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitoret potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitoret potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: http://www.pak-ks.org